



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:296130

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05841191

KF.nr.258/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në konfliktin administrativ të paditësit NTP “Shpeta” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimit, me bazë juridike tatim shtesë, në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor publik, të mbajtur me datë 28.05.2024, në prani të pronarit të palës paditëse personalisht, A.K. dhe në mungesë të përfaqësuesit të të paditurës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit NTP “Shpeta” me seli në Prishtinë.
- II. Anulohet vendimi nr.433/2021 i datës 13.12.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës.
- III. Obligohet e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, që paditësin NTP “Shpeta” Sh.P.K., ta liroj nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TVSH në shumë prej 173,912.87 euro për periudhën 01/2009 dhe të tatimit bazë për TVSH në shumë prej 9,218.50 euro për periudhën 09/2009, ta liroj nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TAI/2009 në shumë prej 4,635.40 euro (në pasqyrën financiare për TAI/2009 në pozicionin KMSH stornohet (zbritet) stoku i bartur i bizneseve familjare sipas çmimit furnizues në shumë prej 910,435.45 euro dhe në rubrikën fitimi para tatimit të shënohet humbja në vlerë prej 47,383.37 euro, periudha 2010 lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TVSH në shumë prej 2,757.66 euro për periudhën 02/2010 dhe të tatimit bazë për TVSH në shumë prej 11,080.10 euro për periudhën 12/2010, lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TAI/2010 në shumën prej

4,373.42 (në pasqyrën financiare për TAI/2010 në rubrikën fitimi para tatimit shënohet humbja në vlerë prej 40,094.73 euro, dhe periudha 01/2011-07/2011, rritje e kreditimit të TVSH-së në vlerë prej 7,343.87 për periudhën 04/2011.

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, me padinë e parashtruar në gjykatë, me datë 30.12.2021, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës e cila duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Supreme UZVP.ARJ.63/2021 serirësh në ri procedurë vendos njësoj me vendimin nr.433/2021 me të cilin vërteton njoftim rivlerësimin e tatimit shtesë me të cilin paditësi është ngarkuar me tatim shtesë në shumë të përgjithshme prej 446,993.64 euro. Me parashtresën e datës 20.04.2022 ka precizuar kërkesëpadinë sipas periudhave dhe llojit të tatimit : periudha 2008 rritje e kreditimit të TVSH-së në vlerë prej 8,967.57 euro për periudhën 12/2008, Rritje të humbjes në shumë prej 56,047.35 euro në pasqyrën financiare për TAI/2018, periudha 2009: lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TVSH në shumë prej 173,912.87 euro periudhën 01/2009 dhe të tatimit bazë për TVSH në shumë prej 9,218.50 euro për periudhën 09/2009, lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TAI/2009 në shumë prej 4,635.40 euro (në pasqyrën financiare për TAI/2009 në pozicionin KMSH stornohet (zbritet) stoku i bartur bizneseve familjare sipas çmimit furnizues në shumë prej 910,435.45 euro dhe në rubrikën fitimi para tatimit shënohet humbja në vlerës prej 47,383.37 euro, periudha 2010 lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TVSH në shumë prej 2,757.66 euro për periudhën 02/2010 dhe të tatimit bazë për TVSH në shumë prej 11,080.10 euro për periudhën 12/2010, lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TAI/2010 në shumën prej 4,373.42 (në pasqyrën financiare për TAI/2010 në rubrikën fitimi para tatimit shënohet humbja në vlerë prej 40,094.73 euro, dhe periudha 01/2011-07/2011, rritje e kreditimit të TVSH-së në vlerë prej 7,343.87 për periudhën 04/2011. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor - kryesor të datës 04.04.2024 dhe në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i palës paditëse ka deklaruar se ATK-ja nuk e ka respektuar asnjë rekomandim të Bordit të Pavarura dhe instancave më të lartë deri te Gjykata Supreme. Gjykatës i ka propozuar të merr një vendim të formës së prerë duke e liruar paditësin ashtu siç edhe e ka precizuar kërkesëpadinë me datë 20.04.2022.

E paditura, në përgjigje në padi të datës 03.03.2022 ka deklaruar se e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Tutje ka theksuar se DA pas rishqyrtimit të

rekomandimeve të Aktgjykimit ARJ/UZVP nr.63/2021 të Gjykatës Supreme ka marr vendimin 433/2021 dhe ka refuzuar ankesën e paditësit në riprocedurë dhe ka lënë në fuqi njoftim vlerësimet e tatimit shtesë të caktuara me kontroll. Ka shtuar se njoftim vlerësimet e dala nga kontrolli janë të bazuara në nenin 17 të Ligjit nr.2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, sa i përket tatimit shtesë i cili ka rezultuar për shkak të bartjes së stokut nga subjekti “Shpeta” tek subjekti “Shpeta-2MA”, në vlerë prej 290,614.55 euro dhe fletë regjistrimi i stoqeve i datës 31.12.2009 i nënshkruar nga personi përgjegjës i subjektit NTP “Genita”, si pranues i stoqeve të bartura nga subjekti “Shpeta” në vlerë prej 619,820.99 euro. Në riprocedurë ATK-ja konstaton se statusi i biznesit të cilësuar nga paditësi si biznese familjare është biznes individual, prandaj të gjitha përgjegjësitë dhe obligimet janë të lidhura me pronarin e biznesit. Tutje ka shtuar se në bazë të dosjes është e qartë se paditësi ka prezantuar kontrata me vëllezërit e tij (realisht pronarë të dy bizneseve të regjistruara në ARBK, që përmbajnë vlerën e mallit që kanë pranuar nga subjekti NTP “Shpeta” mirëpo asnjëherë nga ato të gjitha vizitat dhe përpjekjet e ATK-së ndër vite, tatimpaguesit e përfshirë në këtë transaksion nuk kanë dëshmuar se ky ndërrim i pronësisë së mallit është bërë me qëllim që dy bizneset përfituese do ta rishesin mallin (me të cilin rast do të evidentohet marzha), provë kjo që do ti mundësonte të paditurës të bëjë analizë specifike për shkak të kushteve specifike të zhvillimit të këtyre transaksioneve, përndryshe çdo shitje e mallit e padeklaruar vlerësohet sipas marzhës apo vlerës së hapur të tregut siç është vepruar në këtë rast. Tutje sqaron se sipas sistemit SIGTAS asnjëri biznes në periudhën tatimore 01/2009 dhe 12/2009 te blerjet me TVSH (apo pa TVSH) nuk e ka deklaruar në pasqyra as mujore as vjetore në evidencat kontabël stokun e bartur në fjalë. Në vitin 2019 te subjekti Genita nuk është arritur kontakti me pronarin e biznesit, ndërsa me datë 21.10.2019 konstatohet se subjekti Shpeta -2- MA është vizituar nga inspektori tatimor me qëllim të verifikimit të stokut të bartur në vlerë prej 290,641.55 euro të datës 14.01.2019, dhe vizita është bërë tek selia e regjistrimit të biznesit por i pa mundur kontakti. Me tej ka shtuar se çdo ndërrim i pronësisë së mallit në mes të tri bizneseve të regjistruara në ARBK, me numrat e tyre fiskal është shitje, dhe përderisa nuk kanë prova materiale në shkresat nga të tri subjektet në kontest se vendimet e datës 14.01.2009 dhe 31.12.2009 janë ekzekutuar nga palët, ATK-vlerëson si të bazuar kalkulimin e marzhës përderisa nuk kemi ankesë rreth vlerës së marzhës, Ligji nr.03/L-114. Ndërsa sa i përket kontestit rreth deponimeve në shumën prej 89,711.25 € në muajin 01/2019 nga huadhënësi NTP “Engi”, në shumën prej 6,900.00 në muajin 09/2009 nga huadhënësi "Genita" dhe në shumën prej 20,000.00€ në muajin 02/2010 nga huadhënësi "Engi" te cilat sipas kontrollit janë trajtuar si shitje të padeklaruar, ndërsa paditësi pretendon se janë huamarrje për të disponon kontrata mbi huan. ATK-ja duke bërë një analizë të kontratave mbi

huan dhe kartelave bankare te BPB-së konstaton se shumica e huazimeve janë nga subjekti NPT, “Engi” vërtetohet se qarkullimi i te njëjtit për vitet 2009-2010 është ne vlerë prej 17,140.80€, pra pretendimet e paditësi/tatimpaguesit se mjetet e huazuara janë nga qarkullimi i biznesit dhe kreditë të cilat i ka marr janë për ta ndihmuar biznesin “Shpeta” nuk është i qëndrueshëm me asnjë prove materiale e cila dëshmon të kundërtën e pretendimeve te paditësit, konsiderohet se paditësi/tatimpaguesi ka realizuar të hyra të cilat nuk i ka evidentuara në librat e shitjes dhe të njëjtat nuk i ka deklaruar, gjë që është në kundërshtim me Nenin 12 dhe 15 te Ligjit Nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj ankesën e paditësit dhe ta aprovoj vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.433/2021 datës 12.02.2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 04.04.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi nr. 526/2014, Aktvendimi i BPR A.nr. 42/2012, Vendimi 45/2012, Ankesa e paditësit e datës 29.02.2012, Vendimi i datës 13.12.2009 për bartjen e stokut, Regjistri i stoqeve për subjektin NTP Genita datës 13.12.2009, Vendimi i paditësit për bartjen e stokut e datës 14.01.2009, Kontrata mbi huanë dt:30.09.2009, 16.01.2009, 15.01.2009, Pasqyra e llogarisë bankare për paditësin 09.09.2011, Raporti i kontrollit i datës 20.01.2012, Ekspertizë financiare datës 19.04.2019 dhe plotësim i ekspertizës datës 08.07.2019, Pasqyra e llogarisë bankare në Raiffeisen Bank , Marrëveshje mbi ndarjen e pronës, Dokumentet leje pune të Komunë së Prishtinës, Procesverbali i datës 13.10.2003, Gjendja e përgjithshëm e deklarimeve datës 15.04.2019, Formular i pagesës dhe deklarimit të TVSH të paditësit, Vendimi i Gjykatës Supreme ARJ.nr. 63/2021 datës 28.07.2021.

Gjykata e ka rihapur seancën e shqyrtimit kryesor-publik me datë 28.05.2024 dhe ka administruar këto prova: Raporti i kontrollit datë 20.01.2012, Aktgjykimi UZVP.ARJ.BR 63/2021, Aktgjykim AA nr. 887/2019, Aktgjykim A.nr.520/15 , Vendim nr.526/2014 i datës 12.02.2015, Vendim nr. 433/2021 datës 13.12.2021, Ankesa e paditësit në ATK nr. 45 datës 29.02.2012, Vendim 45/2012 datës 23.04.2012, Ankesë e paditësit në Bord e Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave , Aktvendim i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime A.nr.42/2012 datës 12.12.2014, Padi datës 16.03.2015, Ekspertizë financiare - prill 2019, Ekspertizë financiare plotësuese datës 21.06.2019, Ankesë dt.13.11.2019, Kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm datës 26.05.2021, Përgjigje në padi datës 07.03.2022, Përgjigje në padi datës 10.10.2016, Kundërshtimi i ekspertizës financiare datës 10.06.2019, Aktgjykim AA.nr.887/19 datës

19.03.2021, Vendimet e NTP “Shpeta” datës 14.01.2009, 31.12.2009, Regjistrat e stoqeve të mallit datës 31.12.2008, 31.12.2009, Kontratat mbi huanë të dt.10.02.2010, 15.01.2009, 16.01.2009.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

E paditura sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë ka qenë e obliguar në rivendosje të vërtetohet edhe njëherë faktin se çfarë ka ndodhur me totalin e stokut të paditësit i cili ka qenë i evidentuar me datë 31.12.2018 dhe të sigurohen prova shtesë nga pronarët e subjekteve, e që nga plotësimi i ekspertizës subjekti nuk ka mundur të konstatojë nëse deponimet të cilat paditësi i ka pranuar nga subjektet NTP “Engi “ dhe “Genita” kanë qenë të evidentuara në librat dhe regjistrimet e paditësit, nëse të njëjtat janë deklaruar nga paditësi në bilanci e gjendjes dhe nëse ka pasur kartelë të huamarrjes.

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga deklaratimet në ankesë/padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor, Gjykata ka nxjerr konstatimin se e paditura me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e tatimpaguesin me konstatim se ndërrimi i pronësisë së mallit mes tri bizneseve të regjistruara në ARBK, me numrat e tyre fiskal është shitje, dhe përderisa nuk ka prova materiale në shkresat e lëndës nga tri subjektet në kontest se vendimet e datës 14.01.2009 dhe 31.12.2009 janë ekzekutuar nga palët, DA vlerësoi si të bazuar edhe kalkulimin e marzhës përderisa nuk kemi ankesë rreth vlerës së marzhës, Ligji 03/L-114, ndërsa sa i përket kontesti të tatimpaguesit rreth trajtimit të deponimeve nga NTP “Engi” dhe pretendimet të tatimpaguesit se të njëjtat janë huazime, DA i vlerëson se tatimpaguesi nuk e ka dëshmuar me prova pretendimi e tij, mungojnë të dhënat realisht të njëjtat nuk kanë qenë të evidentuara në libra dhe regjistrime, bilanci e gjendjes dhe nuk ka kartelë të huamarrjes.

Me propozimin e palës, gjykata ftoi në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.04.2024 edhe ekspertin financiar E.G., i cili ka punuar ekspertizën në vitin 2019 dhe plotësimin e ekspertizës.

Sipas ekspertizës financiare dhe plotësimit të ekspertizës financiare rezulton se magazinimi nuk mund të klasifikohet si të ardhura bruto dhe mbi këtë bazë të tatimohet malli. Gjykata konstaton se sipas ligjit 2004/52 paragrafi 3 me të cilin përcaktohet se 3.1 *Objekti i tatimit për tatimpaguesin banor janë të ardhurat e tatueshme nga burimi i të ardhurave nga Kosova dhe burimi i të ardhurave nga jashtë.* 3.2 *Objekti i tatimit për tatimpaguesin jobanor janë të ardhurat e tatueshme nga të ardhurat që e kanë burimin në Kosovë.*, as në ligjin 03/L-115 për Tatimin në të ardhura, nuk mund të interpretohet në dëm të paditësit, respektivisht me të njëjtin nen nuk parashihet investimi bankar si kategori e të ardhurave të parapara për tatimin.

Lidhur me kontestin rreth mospranimit të faktit për mallin e magazinuar në vlerë prej 910.435,54 euro të cilën paditësi e ka bartur nga biznesi familjar i subjektit afarist “Shpeta 2MA” në subjektin afarist “Genita” eksperti ka konstatuar se në mënyrë të mjaftueshme dhe plotësisht të qartë ka provuar se kush ka bartur dhe kush e ka pranuar mallin duke treguar me këtë rast vendimin për transferin e mallit të datës 14.01.2009 dhe të datës 31.12.2009 të nënshkruar nga drejtori kompetent A.K..

Lidhur me qarkullimin shtesë dhe tatimin e shtuar për mallin e magazinuar në vlerë prej 910.435,54 euro të cilën paditësi e ka bartur nga biznesi familjar i subjektit afarist “Shpeta 2MA” në subjektin afarist “Genita” e paditura e ka ngarkuar paditësin me marzhën mesatare vjetore prej 5.8 % ashtu që bartjen e mallit të magazinuar e ka vlerësuar si mungesë me arsyetimin se dy subjektet e cekura në sistemin SIGTAS nuk e kanë deklaruar vlerën e njëjte, e që sipas ekspertizës financiare është konstatuar se paditësi në mënyrë të mjaftueshme dhe plotësisht të qartë ka provuar se kush e ka bartur dhe kush e ka pranuar mallin, duke e prezantuar vendimin mbi transferimin e mallit të datës 14.01.2009 dhe vendimin e datës 31.12.2009 të firmosur nga personi kompetent- Drejtori A.K. duke ofruar fletëregjistrimin e mallrave të transferuara të firmosura nga pranuesit e mallrave z. M.K., në emër të NTP “Shpeta 2- MA” NRB 70549379 në vlerë prej 290,614.55 euro A.K. në vlerë prej 619,820.99 Euro.

E paditura në raportin e kontrollit është thirr në nenin 39 të Ligjit 03/L-146 kur ka arsyetuar kontestin rreth bartjes së mallit të magazinuar të biznesit familjar pas ndarjes së bashkësisë familjare ku nga vlera e përgjithshme prej 1.48.763,32 të regjistruar me datën 31.12.2008, ndërsa sipas kontrollit të kryer vlera e saj ka qenë 1,536.428.19 euro, ndërsa sipas paditësit me datën 14.01.2009 është bërë bartja në subjektin “Shpeta 2MA” në shumë prej

290.614,55 euro dhe me datën 31.12.2009 në subjektin tjetër “Genita” në shumë prej 614,820,99 euro.

Neni 39 i Ligjit 2004/48 rregullon bartjet e transaksioneve në mes të personave të lidhur dhe se në rastin konkret nuk duhet zbatuar, pastaj me nenin 22 të Ligjit nr.03/L-071, rregullohet bartja e pronës së përgjithshme, e që në rastin konkret është fjala për bartje të mallit të magazinuar te biznesit familjar tek dy bizneset tjera. Pretendimet e të paditurës se vendimi është marr mbi bazën e dispozitave të lartcekura ligjore kjo gjykatë nuk i mori si të bazuara, kjo për faktin se asnjëra nuk i referohet rastit konkret.

Lidhur me huazimet nga NTP “Engi” gjykata vlerësoi ekspertizën si dhe deklarin e ekspertit nga seanca gjyqësore i cili lidhur me huazimet ka deklaruar se: *ATK këtë huamarrje e ka konsideruar si një shitje të “Shpeta”, ndoshta ka pasur elemente të dyshimit sepse në huazime është përmendur edhe numri i faturave, mirëpo sipas mendimit tim nëse një transfer bëhet nga një llogari në tjetrin dhe arsyeja se ka ndodh shitblerje është e pa mjaftueshme të besohet nëse nuk janë bërë verifikimet e domosdoshme siç janë dalja e mallit nga shitësi tek blerësi përmes pranim dorëzimit si te njëra palë dhe te tjetra, si dhe informacione tjera siç është transporti, firmosja e dhënies dhe pranimit të mallit dhe ATK i ka besuar më shumë blerësit se sa shitësit pa bërë verifikime se a e ka realizuar blerjen blerësi dhe ky veprim ka pasur pasoja financiare sepse ATK e ka trajtuar këto huazime si shitje të “Shpeta” dhe i ka trajtuar si bazë të përfitimit të ardhura neto dhe si bazë tatimor të tvsh-së.*

Sipas analizës së ekspertit, baza e pretendimeve të të paditurës mbi rritjen e marzhës ka qenë e paqëndrueshme dhe e pavlefshme, duke injoruar ndarjen fizike të mallrave sipas njësave shitëse. Gjithashtu, vlerësimi i huazimeve është kryer në mënyrë që nuk ka reflektuar aspekte të rëndësishme të transaksioneve.

Gjykata, pasi ka vlerësuar argumentet dhe deklaratat e të dyja palëve, si dhe përgjigjet e ekspertit financiar, vlerëson se ekspertiza financiare ofruar nga eksperti financiar E.G. ka sjellë argumente të qëndrueshme dhe të përshtatshme për rastin në fjalë. Gjithashtu, ekspertiza ka bërë të qartë qëndrimet e palës paditëse në lidhje me interpretimin e ligjit dhe trajtimin e të dhënave financiare në kontekstin e lëndës.

Gjykatat konstaton se e paditura nuk ka vepruar fare sipas rekomandimeve të dhëna nga Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj UZVP.ARJ.nr.63/2021.

Për këto arsye, Gjykata vendos se pretendimet e të paditurës nuk janë të mbështetura në bazë të argumenteve të qëndrueshme dhe të paanshme, dhe kështu nuk janë aprovuar.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-202, për Konfliktet Administrative, Neni 46, paragrafi 1. “Gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim”, paragrafi 2. “Me aktgjykim, padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar”. Paragrafi 3. “Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar”, paragrafi 4. “Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”, dhe paragrafi 5. “Me aktgjykim, me të cilin anulohet akti i kontestuar administrativ, gjykata do të vendosë edhe për kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për kompensimin e dëmit, nëse të dhënat e procedurës japin për këtë gjë bazë të sigurt. Në të kundërtën, gjykata do ta udhëzojë paditësin që kërkesën e vet ta realizojë në procedurën kontestmore”.

Rrjedhimisht, bazuar në këtë gjendje të fakteve, Gjykata aprovoi kërkesëpadinë e paditësit ashtu që obligon të paditurën që paditësi të lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TVSH në shumë prej 173,912.87 euro periudhën 01/2009 dhe të tatimit bazë për TVSH në shumë prej 9,218.50 euro për periudhën 09/2009, të lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TAI/2009 në shumë prej 4,635.40 euro (në pasqyrën financiare për TAI/2009 në pozicionin KMSH stornohet (zbritet) stoku i bartur bizneseve familjare sipas çmimit furnizues në shumë prej 910,435.45 euro dhe në rubrikën fitimi para tatimit shënohet humbja në vlerës prej 47,383.37 euro, periudha 2010 lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TVSH në shumë prej 2,757.66 euro për periudhën 02/2010 dhe të tatimit bazë për TVSH në shumë prej 11,080.10 euro për periudhën 12/2010, lirohet nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit bazë për TAI/2010 në shumën prej 4,373.42 (në pasqyrën financiare për TAI/2010 në rubrikën fitimi para tatimit shënohet humbja në vlerë prej 40,094.73 euro, dhe periudha 01/2011-07/2011, rritje e kreditimit të TVSH-së në vlerë prej 7,343.87 për periudhën 04/2011.



Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet dhe provat e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, Gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64, të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Mbi bazën e të lartshënuarve, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1 dhe 46 par. 1, 2, 3, 4, dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.258/22 datë 28.05.2024

Gjyqtarja  
Vera Gashi Bala

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.